

Dokument Përmbledhës

Arsimimi me kohë të pjeshme në Shqipëri

Maj 2024



Ambasciata d'Italia
Tirana



unicef
for every child

Dokument përmbledhës

“Arsimimi me kohë të pjesshme në Shqipëri”

Ky Dokument u përgatit nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve në zbatim të programit “Reaching the Unreached 2”, në kuadër të projektit “QENDRO në shkollë” financuar nga qeveria italiane nëpërmjet Ambasadës Italiane në Tiranë dhe zbatuar nga UNICEF.

Të gjitha të drejtat për këtë Dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Republikës së Shqipërisë dhe ato ndërkombëtare. Ky Dokument nuk mund të kopjohet, të ndahet, të përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë Dokument janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë medoemos opinionin zyrtar të UNICEF-it, si dhe Ambasadës Italiane në Tiranë.

Mirënjohje

Dokumenti përmbledhës “Arsimimi me kohë të pjesshme në Shqipëri” ka për qëllim pasqyrimin e informacionit aktual dhe atij krahasues në lidhje me arsimimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë dhe në gjimnaz në Shqipëri.

Ky dokument mundësohet në zbatim të programit “Reaching the Unreached 2”, në kuadër të projektit “QENDRO në shkollë” financuar nga qeveria italiane nëpërmjet Ambasadës Italiane në Tiranë dhe zbatuar nga UNICEF. Ai u përgatit nga znj. Eridjona Vallja (Observatori) dhe znj. Elma Tërshana (Observatori) në bashkëpunim me z. Bernard Zeneli (konsulent).

Falënderime dhe mirënjohje i shkojnë për kontributin dhe ekspertizën e ofruar në finalizimin e këtij Dokumenti znj. Zamira Gjini-Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ky Dokument u përpunua dhe u redaktua nga z. Besnik Rama, specialist në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të cilin e falënderojmë për kontributin dhe punën profesionale.

Ekipi i punës falënderon znj. Linda Bushati-UNICEF, për gjithë mbështetjen e dhënë.

Maj, 2024



Tabela e përmbajtjes

I. Përmbledhje Ekzekutive	9
1.1 Korniza Ligjore për Arsimin Parauniversitar me Kohë të Pjesshme në Shqipëri	9
1.2 Arsimi i Detyrueshëm (Bazë) në Një Mjedis me Kohë të Pjesshme	9
1.3 Ofertë me Kohë të Pjesshme për Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm (GJKP)	11
1.4 Përmbledhje e Rekomandimeve	12
II. Hyrje	17
III. Kuadri ligjor për arsimimin me kohë të pjesshme në arsimin parauniversitar (në arsimin bazë dhe në gjimnaz) në Shqipëri	18
IV. Arsimi bazë me kohë të pjesshme (ABKP)	21
4.1 Si funksionon ABKP në Shqipëri?	21
4.2 Institucionet që ofrojnë ABKP në Shqipëri	21
4.3 Programet e ofruara	24
4.4 Shpeshtësia e ofrimit të ABKP-së	25
4.5 Grupet e synuara (përfaqësimi gjinor, vendndodhja, situata social- ekonomike)	25
4.6. Roli organizativ dhe mbikqyrës i Bashkisë në ABKP dhe GJKP	26
4.7 Praktika e zbatimit të ABKP	27
V. Gjimnazi me kohë të pjesshme (GJKP)	31
5.1 Si funksionon GJKP në Shqipëri?	31
5.2 Institucionet që ofrojnë GJKP-të në Shqipëri	32
5.3 Programet e ofruara	33
5.4 Shpeshtësia e ofrimit të GJKP-së	34
5.5 Grupet e synuara (përfaqësimi gjinor, vendndodhja)	34
5.6 Praktika e zbatimit të GJKP	36
VI. Përfundime	42
VII. Rekomandime	43

Lista e shkurtimeve

ABKP	Arsimi bazë me kohë të pjesshme
AKAP	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
GJKP	Gjimnazi me kohë të pjesshme
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
MAS¹	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Observatori	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
SMIP	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

¹ Në këtë dokument është përdorur dhe termi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) për faktin se emërtimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin ka ndryshuar ndër vite.

Lista e Grafikëve

Nr i Grafikut Emërtimi i Grafikut

- | | |
|-----------------|--|
| Grafik 1 | Të dhënat krahasuese për nr e shkollave të ABKP-të në nivel kombëtar |
| Grafik 2 | Të dhënat për ABKP në nivel kombëtar për vitin shkollor 2019-2020 |
| Grafik 3 | Të dhënat krahasuese për nxënësit e ABKP-së në nivel kombëtar për vitin shkollor 2019-2020 dhe 2021-2022 |
| Grafik 4 | Të dhënat krahasuese për nr e shkollave të GJKP-të në nivel kombëtar |
| Grafik 5 | Të dhënat për GJKP-të në nivel kombëtar për vitin shkollor 2019-2020 |
| Grafik 6 | Të dhënat krahasuese për nxënësit e GJKP-ve në nivel kombëtar në 10 vitet e fundit |
| Grafik 7 | Të dhënat gjinore të nxënësve në GJKP-të në nivel kombëtar në 10 vitet e fundit |
| Grafik 8 | Grup-mosha e nxënësve të regjistruar në GJKP-të në nivel kombëtar |



Lista e Tabelave

Nr i tabelave Emërtimi i tabelave

Tabela 1	# i nxënësve të ndarë në grupmosha që tyre që ndjekin këtë arsim gjatë këtyre dy viteve të fundit
Tabela 2	# total i personave në ABKP
Tabela 3	# i nxënësve të ndarë në grupmosha që tyre që ndjekin këtë arsim gjatë këtyre dy viteve të fundit
Tabela 4	# total i personave në GJKP
Tabela 5	Vendbanimi dhe profesionet e personave në GJKP



Termet kyç të dokumentit

Termi	Shpjegimi
Arsimi parauniversitar	<p>“Arsimi parauniversitar” përfshin nivelet arsimore me kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas “Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit”, të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në sesionin e 29-të të saj, në nëntor 1997, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none">a) “Niveli me kodin 0”, arsimi parashkollor;b) “Niveli me kodin 1”, arsimi fillor;c) “Niveli me kodin 2”, arsimi i mesëm i ulët;ç) “Niveli me kodin 3”, arsimi i mesëm i lartë.
Arsimi bazë	<p>“Arsimi bazë” përfshin arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët.</p>
Gjimnaz	<p>“Gjimnaz” është shkolla e mesme e përgjithshme.</p>
Arsimimi me kohë të pjesshme	<p>“Arsimimi me kohë të pjesshme” në sistemin arsimor parauniversitar është një nga tri format e ofrimit të shërbimit arsimor për të gjithë të interesuarit mbi moshën 16 vjeç.</p>
SMIP	<p>“Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Arsimor” (SMIP) është një sistem kombëtar i të dhënave arsimore për sistemin arsimor parauniversitar, i cili bën të mundur digjitalizimin e amzës fizike duke ngritur kështu amzën digjitale dhe regjistrin elektronik të notave e mungesave.</p>

I. Përmbledhje Ekzekutive

1.1 Korniza Ligjore për Arsimin Parauniversitar me Kohë të Pjesshme në Shqipëri

Themeli ligjor për arsimin parauniversitar me kohë të pjesshme në Shqipëri është Kushtetuta, e cila i garanton çdo qytetari të drejtën e arsimit sipas nenit 57, që përfshin arsimin e detyrueshëm dhe disponueshmërinë e arsimit të mesëm publik. Legjislacioni kyç përfshin Ligjin Nr. 69/2012, i cili siguron një bazë ligjore gjithëpërfshirëse për sistemin arsimor parauniversitar, duke theksuar gjithëpërfshirjen. Përveç kësaj, Udhëzimi Nr. 29, datë 2.8.2013, përshkruan procedurat e zbatimit të arsimit të mesëm bazë dhe të përgjithshëm në kohë të pjesshme, duke ofruar një qasje të strukturuar të arsimit me kohë të pjesshme.

1.2 Arsimi i Detyrueshëm (Bazë) në Një Mjedis me Kohë të Pjesshme

Arsimi Bazë me Kohë të Pjesshme (ABKP) në Shqipëri është projektuar për individët e moshës 16 vjeç e lart që nuk kanë përfunduar arsimin bazë gjatë moshës së detyrueshme shkollore. Ky program është përshtatur për të përmbushur nevojat e individëve që punojnë dhe atyre me angazhime të tjera. Procesi i regjistrimit është i drejtpërdrejtë, duke kërkuar një kërkesë, kartë identiteti dhe certifikatën e fundit të shënuar të plotësuar ose një dokument ekuivalent për ata që kanë studiuar jashtë vendit.

Shkollat nëntëvjeçare të përzgjedhura në të gjithë Shqipërinë ofrojnë ABKP. Pjesëmarrësit fillestarë përfshinin shkolla si "Adem Gjeli" në Fushë-Krujë, "Lidhja e Prizrenit" në Tiranë dhe "Dëshmorët e Prishtinës" në Shkodër. Deri në vitin akademik 2016-2017, në program u bashkuan shkolla shtesë si "Llambi Goxhomani" në Berat dhe "Zoi II" në Velabisht Berat. Aktualisht (2024) janë 16 shkolla të ABKP në Shqipëri, në raport me 18 shkolla të ABKP që kanë qenë në vitin 2020. Nga të dhënat e fundit zyrtare të aksesueshme nga MAS, rezultojnë 41 klasa gjithsej në shkollat e ABKP, nga të cilat 22 janë klasa të bashkuara ndërsa 19 janë të veçanta. Ndërkohë, numri

mesatar i nxënësve

për klasë për vitin shkollor 2019-2020 është 14.5. Aktualisht, ABKP-ja në Shqipëri numëron 317 nxënës. Në raport me vitin 2020, vihet re një ulje e numrit të nxënësve në ABKP me 47% (595 nxënës kanë qenë të regjistruar në vitin 2020, nga të cilët 30% femra dhe 70% meshkuj).

Programi mësimor pasqyron atë të arsimit bazë me kohë të plotë, por është përshtatur me një orar me kohë të pjesshme, duke u përqendruar tek të rriturit dhe individët mbi 16 vjeç që humbën mundësinë për të përfunduar arsimin bazë. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) mbikëqyr respektimin e standardeve ligjore, monitoron performancën e shkollës dhe mbështet institucionet në dhënien e arsimit efektiv. Mësimi zhvillohet 30 orë në javë dhe zgjat nëntë vite shkollore (klasat I-IX).

Paketa kurrikulare për ABKP përfshin:

- a. *planin mësimor të ABKP*
- b. *programet lëndore për çdo klasë për të gjitha lëndët dhe fushat e të nxënit*

Plani mësimor për ABKP, i miratuar nga MAS:

- Përcakton lëndët/fushat e të nxënit për çdo klasë dhe numrin e orëve përkatëse;
- Është ndërtuar bazuar në planin mësimor të arsimit bazë me kohë të plotë, duke u mbështetur në përvojat e punës me nxënësit që ndjekin këto klasa. parashikon zhvillimin e moduleve;
- Sugjeron që në arsimin fillor (klasat 1-5) të zhvillohen veprimtari edukative dhe argëtuese, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) të zhvillohen module/veprimtari praktike të cilat synojnë pajisjen e nxënësve me njohuri dhe aftësi të thjeshta nga fusha të ndryshme profesionale;
- Plani mësimor dhe programet lëndore të ABKP hartohen nga institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe miratohen nga ministri i arsimit;
- Plani mësimor dhe struktura e vitit shkollor njoftohen në udhëzimin e vitit shkollor.

Programet lëndore janë hartuar për çdo lëndë mësimore, për secilën klasë, në përmbushje të planit mësimor. Këto programe janë bazuar në programet lëndore të arsimit bazë me kohë të plotë, në përmbushje të filozofisë së kurrikulës dhe zhvillimit të kompetencave kyç dhe atyre lëndore.

1.3 Ofertë me Kohë të Pjesshme për Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm (GJKP)

Arsimi i mesëm i përgjithshëm me kohë të pjesshme (GJKP) ofron mundësi edukimi fleksibël për ata që nuk janë në gjendje të ndjekin shkollën e mesme me kohë të plotë, duke iu përmbajtur standardeve kombëtare arsimore. Lëndët thelbësore janë identike me ato në arsimin me kohë të plotë, por të strukturuar për nxënësit me kohë të pjesshme. Udhëzimi Nr. 21, datë 18.08.2016, detajon të drejtat, kriteret, procedurat e regjistrimit, vlerësimin, pjesëmarrjen, programin mësimor dhe përgjegjësitë e institucioneve arsimore vendore.

Institucionet që ofrojnë arsim të mesëm me kohë të pjesshme caktohen brenda çdo njësie arsimore vendore, zakonisht në zonat qendrore urbane. Nëse numri i studentëve të regjistruar i kalon 300, krijohet një institucion i posaçëm arsimor. Aktualisht në të gjithë Shqipërinë funksionojnë 16 shkolla të mesme me kohë të pjesshme, nga 15 që ishin në vitin 2020. Sipas të dhënave të fundit zyrtare të aksesueshme janë të hapura 138 klasa në GJKP, në të cilat japin mësim gjithsej 72 mësues me normë të plotë mësimore, ndërsa pjesa tjetër e orëve të planit mësimor mbulohet nga mësuesit e gjimnazeve me kohë të plotë. Ndërkohë, numri mesatar i nxënësve për klasë për vitin shkollor 2019-2020 është 33.4. Në vitin shkollor 2021-2022, 4915 nxënës kanë ndjekur GJKP-të në Shqipëri, nga të cilët 42% (2087) janë vajza/gra përkundrejt 58% (2828) djem/burra. Në raport me 10 vite më përpara, vihet re një ulje e numrit të nxënësve në GJKP me 67% (4610 nxënës kanë qenë të regjistruar në vitin shkollor 2011-2012, nga të cilët 37% vajza/ gra dhe 63% djem/burra).

Në GJKP bazuar në planin mësimor, zbatohet kurrikula e zakonshme, e reduktuar në raport me sasinë e orëve mësimore në javë (gjimnazi me kohë të plotë ofron mësim 5 ditë në javë ndërsa GJKP ofron mësim në 3 ditë në javë) dhe me kohëzgjatjen vjetore

(gjimnazi me kohë të plotë zgjat 3 vjet, GjKP zgjat 4 vjet). IZHA harton udhëzimin për zbatimin e programeve lëndore të GjKP-së, bazuar në programet lëndore të gjimnazit me kohë të plotë.

GjKP synon të rriturit që punojnë, prindërit e rinj dhe të tjerë që kanë nevojë për mundësi shkollimi fleksibël për shkak të angazhimeve personale ose profesionale, si dhe ata që dëshirojnë të vazhdojnë edukimin e tyre pas një pushimi. Praktikrat më të mira në arsimin e mesëm me kohë të pjeshme përfshijnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional për mësuesit, përdorimin e metodave të të nxënës të përzier dhe monitorimin nga afër të përparimit të nxënësve për të ofruar mbështetje shtesë sipas nevojës.

1.4 Përmbledhje e Rekomandimeve

Për të rritur efektivitetin e arsimit parauniversitar me kohë të pjeshme në Shqipëri, propozohen disa rekomandime, në përputhje me zhvillimet më të fundit të BE-së. Këto rekomandime duhet të zhvillohen më tej në bashkëpunim me institucione të ngjashme në vendet evropiane për të gjetur zgjidhje efektive që trajtojnë detyrimet e arsimit kushtetues dhe nevojat e shoqërisë dhe tregut të punës. Duke u inspiruar nga vende si Irlanda, ku sistemi mbështetës për arsimin me kohë të pjeshme është i lidhur me politikat e rinisë dhe të tregut të punës në kuadrin e Garancisë Rinore, nismës së BE-së nga e cila përfiton Shqipëria, studimi propozon rekomandimet e mëposhtme:

- **Përmirësimi i Ofertës së Arsimit të Detyrueshëm:** Përshtatja e programit mësimor me metodat e mësimdhënies për të rritur është thelbësore për ta bërë mësimin më të arritshëm dhe më të efektshëm për studentët e pjekur. Kjo përfshin inkorporimin e qasjeve ndëraktive dhe praktike të të mësuarit të përshtatura për nxënësit e rritur. Përdorimi i teknologjive të edukimit digjital mund të lehtësojë mundësitë e vetë-mësuarit dhe dalluese të të mësuarit, duke i lejuar studentët të studiojnë me ritmin e tyre dhe sipas orarit të tyre. Kjo mund të arrihet duke zhvilluar platforma dhe burime online që ofrojnë materiale të plota mësimi, tutoriale dhe module ndëraktive.

- **Rishikimi i Kornizës Ligjore për të Rritur Aksesin dhe për të Lehtësuar Përfundimin e Arsimit të Detyrueshëm:** Rishikimi i kuadrit ligjor është vendimtar për të mundësuar dhënien e provimeve për individët që janë autodidakt në shtëpi. Kjo do t'u lejonte nxënësve të certifikonin njohuritë dhe aftësitë e tyre nëpërmjet vlerësimeve formale, edhe nëse nuk kanë ndjekur klasat tradicionale.
- **Përmirësimi i Arritshmërisë dhe Ndërgjegjësimit:** Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për disponueshmërinë dhe përfitimet e arsimit me kohë të pjesshme është thelbësore. Kjo mund të arrihet nëpërmjet fushatave informative dhe promovimeve në platformat sociale dhe tradicionale të medias për të arritur një audiencë të gjerë. Organizimi i fushatave ndërgjegjëse në komunitete të ndryshme, veçanërisht në zonat rurale, mund të rrisë ndjeshëm pjesëmarrjen në këto programe. Duke theksuar fleksibilitetin dhe avantazhet e arsimit me kohë të pjesshme, më shumë individë do të inkurajohen të ndjekin mundësitë arsimore që përshtaten me angazhimet e tyre personale dhe profesionale.
- **Përdorimi i Shkollave të Papërdorura për Arsimin me Kohë të Pjesshme:** Këshillohet shndërrimi i shkollave që nuk janë në përdorim, duke ndarë të paktën një për qark, në institucione të dedikuara për arsimin me kohë të pjesshme. Këto institucione duhet të pajisen me staf të specializuar mësimor të trajnuar në metodologjitë e edukimit të të rriturve, duke siguruar një mjedis të favorshëm për mësim dhe mbështetje.
- **Përforcimi i Mbështetjes për Pjesëmarrësit e Arsimit me Kohë të Pjesshme:** Zbatimi i shërbimeve të këshillimit dhe mbështetjes për pjesëmarrësit është thelbësor për të ndihmuar ata të menaxhojnë detyrimet e tyre arsimore dhe personale. Ofrimi i trajnimeve të rregullta dhe zhvillimit profesional për mësuesit që janë të përfshirë në programe me kohë të pjesshme do të sigurojë që ata të jenë të përgatitur për të përmbushur nevojat e nxënësve të rritur dhe për t'i udhëhequr ata në mënyrë efektive drejt suksesit arsimor.
- **Ofrimi i Trajnimeve të Vazhdueshme dhe Zhvillimi Profesional për Mësuesit:** Edukimi i mësuesve me aftësitë për të trajtuar nevojat specifike të nxënësve të

rritur dhe përdorimi i metodave novatore të mësimdhënies është vendimtar. Kjo përfshin trajnimin në teknologjinë moderne dhe metodologjitë e mësimdhënies për të rritur, si dhe zhvillimin e aftësive të tyre të komunikimit dhe aftësisë për të motivuar studentët. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional siguron që mësuesit të jenë të pajisur për të dhënë arsim të cilësisë së lartë që plotëson nevojat unike të nxënësve të rritur, duke rritur efektivitetin e përgjithshëm të programeve të arsimit me kohë të pjesshme.

- **Përditësimet e Rregullta të Programit Mësimor:** Përditësimet e rregullta të programit mësimor janë të nevojshme për t'u përshtatur me standardet aktuale arsimore dhe kërkesat e tregut të punës. Përfshirja e moduleve të mësimi fleksibël dhe aftësive praktike të përshtatura sipas nevojave të nxënësve me kohë të pjesshme mund të rrisë rëndësinë dhe efektivitetin e arsimit të ofruar. Programi mësimor duhet të jetë dinamik, duke pasqyruar zhvillimet e reja në shkencë, teknologji dhe kërkesat e tregut të punës. Zhvillimi i një programi hibrid dhe të përshtetshëm mund të krijojë mundësi për të rriturit që nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm, duke u mundësuar atyre të finalizojnë arsimin e tyre me një provim të ngjashëm me provimet tradicionale të lirisimit.
- **Zbatimi i Sistemeve të Fuqishme të Monitorimit dhe Vlerësimit:** Është jetësore të gjurmohet ecuria dhe përparimi i programeve të arsimit me kohë të pjesshme për të siguruar efektivitetin dhe përgjegjshmërinë e tyre. Zbatimi i sistemeve të fuqishme të monitorimit dhe vlerësimit lejon mbledhjen e të dhënave që mund të informojnë vendimet dhe përmirësimet e vazhdueshme. Një sistem monitorimi i mirëstrukturuar ndihmon në identifikimin e sfidave që në fillim, duke bërë të mundur ndërhyrjet në kohë për t'i trajtuar ato dhe për t'u siguruar që programet të përmbushin nevojat e nxënësve.
- **Eksplorimi i mundësive të financimit për të mbështetur programet e arsimit me kohë të pjesshme:** Kjo përfshin bursa dhe ndihma financiare për studentët që mund të përballen me pengesa ekonomike për të vazhduar arsimin e tyre. Ofrimi i mbështetjes financiare për individët që nuk mund të përballojnë tarifat ose shpenzimet e tjera të lidhura me arsimin, sikundër mund të jetë transporti

për personat që ndjekin ABKP dhe GJKP që e kanë qendrën e banimit/ punës së tyre mbi 2 km larg nga vendndodhja e shkollës, mund të rrisë aksesin dhe pjesëmarrjen. Institucionet arsimore dhe qeveria mund të punojnë së bashku për të identifikuar burime të reja financimi, duke përfshirë financimin ndërkombëtar dhe partneritetin publik-privat. Sigurimi i mbështetjes financiare për individët që nuk mund të përballojnë tarifa apo shpenzime të tjera të lidhura me arsimin mund të rrisë ndjeshëm aksesin dhe përfshirjen e programeve të arsimit me kohë të pjesshme.

- **Promovimi i Njohjes së Përvojave të Punës dhe të Mësuarit Praktik:** Rekomandohet bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Arsimit Profesional, Trajnimit dhe Kualifikimeve për të nxitur njohjen e përvojave të punës dhe të nxënimit praktik si arsim joformal dhe informal. Kjo metodë do t'u lejonte individëve të plotësonin kërkesat e detyrueshme të arsimit duke demonstruar njohuritë dhe aftësitë e tyre të fituara nëpërmjet përvojave të botës reale. Duke pranuar zyrtarisht vlerën e përvojave praktike dhe profesionale, individët mund të shfrytëzojnë kompetencat e tyre ekzistuese për të përmbushur standardet arsimore, duke rritur kështu mundësitë e tyre për përparim personal dhe profesional.
- **Përfundim:** Duke trajtuar këto fusha, Shqipëria ka potencialin të forcojë ndjeshëm sistemin e saj arsimor parauniversitar me kohë të pjesshme, duke e shndërruar atë në një kuadër më gjithëpërfshirës, më efektiv dhe më reagues që plotëson nevojat e larmishme të popullsisë së saj. Përmirësimi i programit mësimor, përmirësimi i arritshmërisë dhe ndërgjegjësimit, dhe ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për mësuesit do të krijojnë një mjedis ku nxënësit e rritur mund të lulëzojnë. Njohja e vlerës së përvojave të punës dhe të mësuarit praktik do t'u mundësojë individëve të përmbushin kërkesat arsimore nëpërmjet aftësive të tyre në botën reale, ndërsa shndërrimi i shkollave të papërdorura në institucione të dedikuara për arsimin me kohë të pjesshme do të sigurojë që këto mundësi të jenë të arritshme për të gjithë.

Për më tepër, përditësimet e rregullta të programit mësimor dhe zbatimi i sistemeve të fuqishme të monitorimit do të sigurojnë që arsimit i dhënë të mbetet i rëndësishëm

dhe efektiv, ndërsa eksplorimi i mundësive të financimit do të lehtësojë pengesat financiare që mund të pengojnë individët të ndjekin arsimin e mëtejshëm. Duke nxitur një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe fleksibël, Shqipëria jo vetëm që do të përmbushë detyrimet e saj kushtetuese, por edhe do të fuqizojë qytetarët e saj për të arritur qëllimet e tyre personale dhe profesionale.

Në fund të fundit, këto përpjekje do të kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë dhe integrimin më të mirë në tregun e punës, duke siguruar që çdo individ, pavarësisht nga mosha, angazhimet profesionale, apo pengesat ekonomike, të ketë mundësinë të përfitojë nga një arsimim i cilësisë së lartë. Kjo metodë tërësore do të hapë rrugën për një popullsi më të arsimuar, më të aftë dhe më të begatë, të aftë për të përballuar sfidat e së ardhmes.

II. Hyrje

Ky dokument u përgatit nga **Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve** (Observatori) me mbështetjen e zyrës së UNICEF Shqipëri në kuadër të Projektit “Reaching the Unreached 2”.

Qëllimi i këtij dokumenti është që të jap një informacion të përgjithshëm mbi situatën e arsimit me kohë të pjesshme në Shqipëri, bazuar në të dhenat zyrtare të mundësuar falë bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS).

Dokumenti jep një informacion në lidhje me kuadrin ligjor për arsimimin me kohë të pjesshme në arsimin parauniversitar (në arsimin bazë dhe në gjimnaz) në Shqipëri. Gjithashtu në dokument paraqitet situata e ofrimit të arsimit bazë me kohë të pjesshme në institucionet e arsimit publik parauniversitar, bazuar në të dhenat e vëna në dispozicion nga MAS.

Përshkrimi është i ndarë në dy pjesë:

- *Pjesa e parë* përshkruan Arsimin bazë me kohë të pjesshme (ABKP), si: Institucionet që ofrojnë ABKP në Shqipëri, Programet e ofruara, Shpeshtësia e ofrimit të ABKP-së, Grupet e synuara;
- *Pjesa e dytë* përshkruan Gjimnazin me kohë të pjesshme (GjKP), si: Institucionet që ofrojnë GjKP-të në Shqipëri, Programet e ofruara, Shpeshtësia e ofrimit të GjKP-së, Regjistrimi në gjimnaz me kohë të pjesshme mbi 18 vjeç, Grupet e synuara.

Në pjesën e fundit të dokumentit jepen përfundimet dhe rekomandimet për arsimimin me kohë të pjesshme.

III. Kuadri ligjor për arsimimin me kohë të pjesshme në arsimin parauniversitar (në arsimin bazë dhe në gjimnaz) në Shqipëri

E drejta për arsimim i përket çdo shtetasi. Kjo gjë sanksionet në ligjin themeltar të Shqipërisë (Kushtetuta e Shqipërisë, neni 57 pika 1). Për rrjedhojë:

- Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj;
- Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë;
- Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie;
- Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.

Arsimimi me kohë të pjesshme në sistemin arsimor parauniversitar është një nga tri format e ofrimit të shërbimit arsimor për të gjithë të interesuarit mbi moshën 16 vjeç. Në shkronjën b) të nenit 16 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sanksionohet: "Format e arsimimit në shkolla janë: a) arsimim me kohë të plotë; b) arsimim me kohë të pjesshme; c) arsimim në distancë".

Arsimimi me kohë të pjesshme ofrohet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar (në arsimin bazë dhe në gjimnaz), duke përmbushur kështu dëshirën dhe nevojat e të rriturve për të plotësuar arsimin bazë të pambaruar në fëmijëri, si dhe arsimin e mesëm, me qëllim rritjen e mundësive e të perspektivës për t'u punësuar apo për të vazhduar arsimin e lartë. *Baza ligjore dhe nënligjore në lidhje me arsimin me kohë të pjesshme në arsimin parauniversitar në Shqipëri është si vijon:*

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë** (Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007; nr.9904, datë 21.4.2008; nr.88/2012, datë 18.9.2012, nr.137/2015, datë 17.12.2015 dhe nr.76/2016, datë 22.7.2016) parashikon arsimimin e fëmijës në nenet 57 dhe 59 në veçanti detyrimin e shtetit për të ofruar një sistem që siguron

arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë.

- **Ligji nr. 69/2012**, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 56/2015 dhe ligjin nr. 48/2018.
- **Udhëzimi nr. 29**, datë 02.08.2013, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme”.
- **Udhëzimi nr. 23**, datë 02.08.2013, “Për ndjekjen e gjimnazit me kohë të pjesshme”.
- **Udhëzimi nr. 21**, datë 18.08.2016, i ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për organizimin dhe funksionimin e gjimnazit me kohë të pjesshme”, i ndryshuar.
- **Udhëzimi nr. 17**, datë 09.05.2018, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), “Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë.”
- **Udhëzimi nr. 24**, datë 19.07.2018, “Për dhënien në përdorim falas dhe kthimin e teksteve shkollore për nxënësit e klasave I- IV të arsimit bazë”, i ndryshuar.
- **Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive, protokolluar në MASR me nr. 7522 prot.**, datë 12.07.2018, në Ministrinë e Brendshme (MB) me nr. 8649 prot., datë 22.10.2018 dhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me nr. 6084 prot., datë 23.10.2018, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”.
- **Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) 666**, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar.

- **Urdhri i përbashkët nr. 292**, datë 28.05.2019, Për miratimin e rregullores për zbatimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet MASR, MB, MSHMS “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”.
- **VKM nr. 486, datë 17.6.2020**, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- **Udhëzimi nr. 21, datë 13.08.2020**, “Për përcaktimin e procedurave për administrimin e teksteve shkollore në përdorimin falas në arsimin parauniversitar”.
- **VKM nr. 511, datë 28.07.2022**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

IV. Arsimi bazë me kohë të pjesshme (ABKP)

4.1 Si funksionon ABKP në Shqipëri?

Udhëzimi nr. 29, datë 2.8.2013 përcakton qartësisht të gjithë procedurat që duhet të ndiqen për ABKP.

Procedurat e regjistrimit

1. Nxënësit që kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk e kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë, kanë të drejtë të regjistrohen në shkollat e ABKP.
2. Dokumentet që duhen për regjistrim janë:
 - (a) kërkesë për regjistrim pranë shkollës;
 - (b) kopje e kartës së identitetit të nxënësit;
 - (c) dëftesë ose vërtetim me nota për klasën e fundit të kryer.
3. Nxënësi, që ka kryer një ose disa vite shkollimi jashtë shtetit, regjistrohet në klasën përkatëse sipas njëvlershmërisë së dokumentit shkollor.

4.2 Institucionet që ofrojnë ABKP në Shqipëri

Shkollat e ABKP-së janë hapur kryesisht pas vitit 2013. Në zbatim të Udhëzimit nr. 29, datë 02.08.2013, "Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme", disa shkolla 9-vjeçare të caktuara nga zyrat arsimore filluan që të ofrojnë arsimim me kohë të pjesshme. Sipas udhëzimit, nxënësit, që kanë mbushur moshën 16 vjeç dhe nuk e kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë, kanë të drejtë të regjistrohen në shkollat e arsimit bazë me kohë të pjesshme. Kjo formë e arsimimit është ofruar fillimisht në pak shkolla që prej vitit 2013. Ndërsa përgjatë *vitit shkollor 2015-2016*, ABKP u konsolidua sidomos në tri shkolla 9-vjeçare:

- "Adem Gjeli" Fushë-Krujë,
- "Lidhja e Prizrenit" Tiranë,
- "Dëshmorët e Prishtinës" Shkodër.

Ndërsa në *vitin shkollor 2016-2017*, ABKP u konsolidua në pesë shkolla 9-vjeçare, ku përpos tre shkollave sa më sipër u shtuan dhe shkollat:


- “Llambi Goxhomani” Berat,
- “Zoi Vangjeli” Velabisht, Berat.

Mësimi me kohë të pjesshme bazohej te plani mësimor dhe programet mësimore për arsimin bazë me kohë të pjesshme.

Pas miratimit dhe zbatimit të kurrikulës me bazë kompetencat, **në shtator 2017 u miratua plani i ri mësimor për arsimin bazë me kohë të pjesshme.**


Udhëzimi nr. 17, datë 09.05.2018, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë”, krijoi lehtësira për ndjekjen e ABKP nga të rriturit që nuk kanë arritur ta mbarojnë arsimin bazë me kohë të plotë, duke u dhënë mundësinë që, ashtu si fëmijët në arsimin bazë me kohë të plotë (që nuk kanë ndjekur dy klasa të njëpasnjëshme), edhe ata të mund të pranohen në një apo dy klasa më të larta se klasa për të cilën zotërojnë dokument shkollor (apo pretendojnë se kanë formimin shkollor për t’u pranuar në klasa më të larta, në mungesë të dokumentit shkollor), duke u provuar nga një komision i ngritur në shkollë. Sipas kreut 4, pika 2 të këtij Udhëzimi, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) cakton shkollën/ shkollat e arsimit bazë ku do të ofrohet ABKP. Aktualisht (2024) janë 16² shkolla të ABKP në Shqipëri, në raport me 18 shkolla të ABKP që kanë qenë në vitin 2020. Këto shkolla të ABKP janë nën juridiksionin e 16 ZVAP-ve në vend (nga 17 ZVAP me shkolla të ABKP nën juridiksion që kanë qenë në vitin 2020).

² Asnjë nga shkollat ABKP nuk është me drejtori më vete.



Grafik 1: Të dhënat krahasuese për nr e shkollave të ABKP-të në nivel kombëtar

Nga të dhënat e fundit zyrtare të aksesueshme nga MAS³, rezultojnë 41 klasa gjithsej në shkollat e ABKP, nga të cilat 22 janë klasa të bashkuara ndërsa 19 janë të veçanta. Ndërkohë, numri mesatar i nxënësve për klasë për vitin shkollor 2019-2020 është 14.5.



Grafik 2: Të dhënat për ABKP në nivel kombëtar për vitin shkollor 2019-2020

³ Për vitin shkollor 2019-2020.

4.3 Programet e ofruara

Kurrikula e arsimit bazë me kohë të pjeshme, sikurse e gjithë kurrikula e arsimit parauniversitar bazuar në Ligjin për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” mbështetet në parimet dhe në filozofinë e kurrikulës me bazë kompetencat. Ajo siguron arsimim cilësor dhe të barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, seksi, pozita shoqërore. Dokumentet e tjera mbështetëse për zbatimin e kurrikulës, si udhëzimi për vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar, udhëzuesit kurrikularë lëndorë apo dokumente të tjera ndihmëse, mbështesin dhe orientojnë mësuesit për zbatimin e programeve lëndore dhe të kurrikulës në përgjithësi.

Krahas dokumenteve themelore të kurrikulës së arsimit bazë, si Korniza Kurrikulare e Arsimit Pararuniversitar, kurrikulat bërthamë për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, korniza e vlerësimit të nxënësve dhe nivelet e arritjeve të kompetencave për çdo lëndë, **paketa kurrikulare për ABKP përfshin:**

- a. *planin mësimor të ABKP*
- b. *programet lëndore për çdo klasë për të gjitha lëndët dhe fushat e të nxënit*

Plani mësimor për ABKP, i miratuar nga MAS:

- përcakton lëndët/fushat e të nxënit për çdo klasë dhe numrin e orëve përkatëse;
- është ndërtuar bazuar në planin mësimor të arsimit bazë me kohë të plotë, duke u mbështetur në përvojat e punës me nxënësit që ndjekin këto klasa. parashikon zhvillimin e moduleve;
- sugjeron që në arsimin fillor (klasat 1-5) të zhvillohen veprimtari edukative dhe argëtuese, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) të zhvillohen module/veprimtari praktike të cilat synojnë pajisjen e nxënësve me njohuri dhe aftësi të thjeshta nga fusha të ndryshme profesionale;

- Plani mësimor dhe programet lëndore të ABKP hartohen nga institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe miratohen nga ministri i arsimit;
- Plani mësimor dhe struktura e vitit shkollor njoftohen në udhëzimin e vitit shkollor.

Programet lëndore janë hartuar për çdo lëndë mësimore, për secilën klasë, në përmbushje të planit mësimor. Këto programe janë bazuar në programet lëndore të arsimit bazë me kohë të plotë, në përmbushje të filozofisë së kurrikulës dhe zhvillimit të kompetencave kyç dhe atyre lëndore.


4.4 Shpeshtësia e ofrimit të ABKP-së

ABKP zgjat nëntë vite shkollore (klasat I-IX). Një nxënës që kthehet të bëjë arsimin me kohë të pjessme, vijon klasën që ka ndërprerë ose futet 2 klasa më lartë, përcaktuar nga stafi shkollor. Shkolla me kohë të pjesshme funksionon me tri ditë në javë (me klasa të veçanta ose të bashkuara). Meqë punohet me programe mësimore të reduktuara të arsimit bazë me kohë të plotë, viti mësimor i ABKP-së është organizuar me një strukturë prej 30 javësh.

4.5 Grupet e synuara (përfaqësimi gjinor, vendndodhja, situata social-ekonomike)

Aktualisht, ABKP-ja në Shqipëri numëron 317 nxënës. Në raport me vitin 2020, vihet re një ulje e numrit të nxënësve në ABKP me 47% (595 nxënës kanë qenë të regjistruar në vitin 2020, nga të cilët 30% femra dhe 70% meshkuj).

Grafik 3: Të dhënat krahasuese për nxënësit e ABKP-së në nivel kombëtar për vitin shkollor 2019-2020 dhe 2021-2022



4.6. Roli organizativ dhe mbikqyrës i Bashkisë në ABKP dhe GJKP

Në Shqipëri, bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e arsimit me kohë të pjesshme në arsimin bazë dhe në gjimnaz. Detyrimet dhe përgjegjësitë e bashkisë në këtë kontekst përfshijnë:

1. Infrastruktura dhe mirëmbajtja:

Sigurimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave shkollore dhe faciliteteve të tjera.

Përmirësimi i kushteve fizike të shkollave për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për nxënësit dhe mësuesit.

2. Promovimi i Bashkëpunimit me Komunitetin:

Nxitja e bashkëpunimit midis shkollave dhe komunitetit vendor për të inkurajuar regjistrimin e të rriturve në arsimimin me kohë të pjesshme që nuk kanë arritur të mbarojnë arsimin bazë në moshën e detyrimit shkollor, apo gjimnazin brenda moshës së lejuar sipas ligjit për sistemin arsimor parauniversitar.

Bashkitë luajnë një rol kyç në sigurimin që shkollat 9-vjeçare me kohë të pjesshme dhe gjimnazet që ofrojnë arsim me kohë të pjesshme të funksionojnë në mënyrë efektive

dhe të ofrojnë një arsim cilësor për të gjithë të rriturit e interesuar. Kjo përfshin një angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin e infrastrukturës, mbështetjen e mësuesve dhe të nxënësve, dhe koordinimin me autoritetet qendrore dhe lokale për të përmbushur nevojat e komunitetit.

4.7 Praktika e zbatimit të ABKP

Observatori gjatë muajit Maj 2024, realizoi disa takime vlerësuese në Bashkinë e Elbasanit, Dibër dhe Durrës. Shkollat që realizojnë ABKP në këto bashki janë:

- Shkolla 9-vjecare “Ptoleme Xhuvani” në Elbasan, dhe
- Shkolla 9-vjecare “Isuf Ferra” Nishtulle, Durrës.

Tabela 1: # i nxënësve të ndarë në grupmosha që tyre që ndjekin këtë arsim gjatë këtyre dy viteve të fundit

ABKP “PTOLEME XHUVANI” ELBASAN	GRUP MOSHA 16-29			GRUP MOSHA 30-40			GRUP MOSHA 40+		
	FEMRA	MESHKUJ	TOTALI	FEMRA	MESHKUJ	TOTALI	FEMRA	MESHKUJ	TOTALI
VITI AKADEMIK 2022 - 2023	05	08	13	10	08	18	11	07	18
VITI AKADEMIK 2023 - 2024	08	03	11	10	05	15	20	16	36

Vëmë re që persona NEET⁴ që ndjekin ABKP ka qenë 13 gjatë vitit akademik 2022 – 2023 dhe 11 persona gjatë vitit 2023 – 2024.

Nga tabela 2 vihet re që numri i vajzave dhe grave që ndjekin ABKP është më i lartë (62) se sa ai i djemve dhe burrave (49); referuar kësaj, duhet të nxiten politika lehtësuese nga Bashkia për të nxitur arsimimin në ABKP, kjo referuar ose lehtësirave për shkak të gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar, vendbanimit, numrit të fëmijëve në kujdestari, si dhe kushteve të tjera social ekonomike të familjes.

⁴ As në arsim, formim profesional apo trajnim (referuar termit në anglisht Neither in Education, Employment or Training)

Table 2: # total i personave në ABKP

ABKP "PTOLEME XHUVANI" ELBASAN	TOTALI I PERSONAVE NË ABKP		
	FEMRA	MESHKUJ	TOTALI
VITI AKADEMIK 2022-2023	26	23	49
VITI AKADEMIK 2023-2024	38	24	62

Përveç mbarëvajtjes së kurrikulës dhe formës së organizimit të orës mësimore në klasat e arsimit me kohë të pjesshëm realizuar nga MAS, Bashkia është përgjegjëse dhe ka rol në organizimin dhe mbikëqyrjen e shkollave ABKP.

Nga komunikimi i realizuar me shkollën që realizon ABKP "Ptoleme Xhuvani" në Elbasan, Bashkia vlerësohet që:

1. Për personat mbi 16 vjec që kanë dëshirë/ nevojë të ndjekin ABKP, *bashkia nuk zbaton mjaftueshëm politika ndihmuese.*
2. Gjatë këtij viti akademik, nga 62 persona që ndjekin ABKP, 6 persona janë me aftësi të kufizuar; *dhe për asnjë nga këto kategori nuk ofron ndonjë lehtësi financiare nga Bashkia.*
3. Do të ishte me dobi dhe në ndihmë të personave që ndjekin ABKP *që të kishin të paktën rimbursim transporti dhe ofrimin e librave falas*, duke përdorur librat që kanë qenë në përdorim nga në arsimin bazë me kohë të plotë të viteve të më parshme.
4. Informimi për hapjen e regjistrimeve për klasat e ABKP bëhet nëpërmjet rrjeteve sociale të shkollës.
5. Dokumentet e nevojshme për regjistrim ABKP janë: (i) kartë identite, (ii) vërtetim notash, (iii) deklaratë;

6. Ditët dhe oraret që zhvillohen orët mësimore në ABKP janë 3 ditë në javë, përgjatë 30 javëve të një viti akademik, me orar 15.00-18.00.

■ ■ *Në shkollën tonë janë 180 fëmijë në arsimin bazë me kohë të plotë dhe 62 persona që ndjekin arsimin bazë me kohë të pjesshme (ABKP). Personat që ndjekin ABKP nuk marrin asnjë mbështetje financiare, ku me vlerë do të ishte të mund të rimbursohet udhëtimi dhe librat (ku librat mund të hynin në qarkullim duke përdorur ato të viteve të mëparshme që depozitohen në shkollë) ■ ■*

(Ilda Nako, shkolla “Ptoleme Xhuvani”, Elbasan)

Rekomandime për ABKP:

- 1.** Bashkia të mund të ofrojë rimbursim transporti për personat që ndjekin ABKP dhe që qendra e banimit/ punës së tyre është mbi 2km larg nga vendndodhja e shkollës.
- 2.** MAS të mund të sigurojë teskte falas të shkollës, - duke riqarkulluar tekstet që kanë qenë në përdorim nga në arsimin bazë me kohë të plotë të viteve të më parshme;
- 3.** Personat AK mbi 16 vjec dhe që ndjekin ABKP të mund tu ofrohet një bonus financiar shtesë nga Bashkia.
- 4.** Adresimi i politikave nxitëse dhe lehtësuese nga Bashkia për të nxitur arsimimin në ABKP, kjo referuar ose lehtësirave për shkak të gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar, vendbanimit, numrit të fëmijëve në kujdestari, si dhe kushteve të tjera social ekonomike të familjes.

5. Bashkia të ketë një rol më aktiv në organizimin e fushatave informuese gjatë periudhës 1 Korrik – 1 Shtator, drejtuar komuniteteve e grupe të ndryshme të interesit për mundësinë e realizimit të ciklit 9 vjecar pa shkëputje nga puna, dhe lehtësirat që ofrohen për ndjekjen e këtij arsimit. Ky informacion mund të jetë dhe pjesë e komunikimit dhe vlerësimit që realizojnë administratorët social në nivel vendor për personat që aplikojnë për asistencë financiare (NE).

6. Ndhimesë mund të jetë dhe hapja e klasave/ kabinetit AKELIUS në këtë shkollë, me qëllim lehtësimin e gjuhës angleze apo gjuhëve të huaja nga këto persona

V. Gjimnazi me kohë të pjesshme (GjKP)

5.1 Si funksionon GjKP në Shqipëri?

Udhëzimi nr. 21, datë 18.08.2016, trajton të drejtën për të ndjekur gjimnazin me kohë të pjesshme (GjKP), kriteret dhe procedurat e regjistrimit në klasën e 10-të dhe në klasat e ndërmjetme, dokumentet për regjistrim, vlerësimin e arritjeve të nxënësve, frekuentimin, kurrikulën e GjKP-së, si dhe detyrat e institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar. Nxënësve, që kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe nuk e kanë përfunduar gjimnazin, u mundësohet ndjekja e gjimnazit me kohë të pjesshme.

Në këtë Udhëzim përcaktohet se GjKP-ja:

1. organizohet në çdo njësi arsimore vendore, e cila, me vendim të posaçëm, cakton 1 (një) institucion arsimor që ofron gjimnazin me kohë të pjesshme;
2. funksionon në qytetin qendër të njësisë arsimore vendore;
3. funksionon si institucion arsimor i veçantë, kur numri i nxënësve të regjistruar është mbi 300.

Shërbimi elektronik (SMIP) u vjen në ndihmë personave mbi 18 vjeç, të interesuar të regjistrohen në klasën e 10-të të gjimnazit me kohë të pjesshme. Kanë të drejtë të regjistrohen në klasën e dhjetë të një gjimnazi me kohë të pjesshme personat që kanë mbaruar arsimin bazë (të detyrueshëm) në një nga shkollat në Republikën e Shqipërisë. Regjistrimi në gjimnaz me kohë të pjesshme bëhet në gjimnazin me kohë të pjesshme që është në juridiksion të ZVAP-së ku i interesuari ka vendbanimin.

Të gjithë nxënësit që janë regjistruar në një gjimnaz apo në një shkollë tjetër, kanë të drejtë të bëjnë çregjistrimin apo anulimin e aplikimit deri një ditë para fillimit të vitit shkollor.


Aplikanti që ka mbaruar arsimin bazë para funksionimit të SMIP-it dhe do të regjistrohet në gjimnazin me kohë të pjesshme, duhet të shkarkojë në sistem dëftesën e arsimit bazë (dëftesën e lirimit). Në mungesë të saj, vërtetimin origjinal me nota dhe me fotografi, lëshuar nga drejtori i shkollës dhe konfirmuar nga ZVAP-ja, ose kopje e faqes së plotë të amzës, lëshuar nga Zyra e Arkivit të Shtetit.

Nxënësi që vazhdon gjimnazin me kohë të pjesshme, nuk mund të transferohet në gjimnazin me kohë të plotë për shkak të planit mësimor (me më pak lëndë) dhe sasisë së orëve javore e vjetore të mësimin. Nxënësi mbi 18 vjeç që vazhdon gjimnazin me kohë të plotë, ose e ka lënë pa e mbaruar atë, mund të transferohet (apo të regjistrohet) në gjimnazin me kohë të pjesshme.

5.2 Institucionet që ofrojnë GjKP-të në Shqipëri

GjKP-të janë hapur thuajse gjatë dhjetë viteve të fundit, edhe pse gjimnazet me korrespondencë, dhe më pas me kohë të shkurtuar, kanë funksionuar dhe më parë.

Nga të dhënat e fundit zyrtare të aksesueshme⁵ janë 16⁶ GjKP në Shqipëri, në raport me 15 GjKP që kanë qenë në vitin 2020. Këto GjKP janë nën juridiksionin e 15 ZVA-ve në vend⁷ (nga 13 ZVAP me GjKP nën juridiksion në vitin 2020).




Grafik 4: Të dhënat krahasuese për nr e shkollave të GjKP-të në nivel kombëtar

⁵ Për vitin shkollor 2021-2022.

⁶ Nga të cilat, 4 GjKP janë me drejtori më vete: "O. Lasko" Shkozë, Durrës; "K. Kristoforidhi" Tiranë; ShMKSh Fier dhe GjKP Berat.

⁷ Dibër, Durrës, Krujë, Tiranë, Fier, Gjirokastrë, Vlorë, Berat, Skrapar, Elbasan, Librazhd, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër.

Sipas të dhënave të fundit zyrtare të aksesueshme⁸ janë të hapura 138 klasa në GjKP, në të cilat japin mësim gjithsej 72 mësues me normë të plotë mësimore, ndërsa pjesa tjetër e orëve të planit mësimor mbulohet nga mësuesit e gjimnazeve me kohë të plotë. Ndërkohë, numri mesatar i nxënësve për klasë për vitin shkollor 2019-2020 është 33.4.



Grafik 5: Të dhënat për GjKP-të në nivel kombëtar për vitin shkollor 2019-2020

5.3 Programet e ofruara

GjKP-të punojnë me planin mësimor përkatës, të miratuar nga MAS-i me nr. 7380 prot., datë 20.07.2016. Në Udhëzimin e përbashkët nr. 18, datë 20.08.2019, "Për vitin shkollor 2019-2020 në sistemin arsimor parauniversitar", GjKP-ja përmendet vetëm në fund të shtojcave, ku udhëzohet që "Në gjimnazin me kohë të pjesshme do të zbatohet plani mësimor me kohë të pjesshme, miratuar me nr. 7380 prot., datë 20.07.2016"⁹.

⁸ Për vitin shkollor 2019-2020.

⁹ Në udhëzimet e përvitshme është bartur thujse i njëjti formulim, duke theksuar që zbatohet po ky plan mësimor.


Në GjKP bazuar në planin mësimor, zbatohet kurrikula e zakonshme, e reduktuar në raport me sasinë e orëve mësimore në javë (gjimnazi me kohë të plotë ofron mësim 5 ditë në javë ndërsa GjKP ofron mësim në 3 ditë në javë) dhe me kohëzgjatjen vjetore (gjimnazi me kohë të plotë zgjat 3 vjet, GjKP zgjat 4 vjet). IZHA harton udhëzimin për zbatimin e programeve lëndore të GjKP-së, bazuar në programet lëndore të gjimnazit me kohë të plotë.

5.4 Shpeshtësia e ofrimit të GjKP-së


GjKP zgjat 4 (katër) vite shkollimi dhe funksionon me tri ditë mësim në javë. Shumica e GjKP-ve e zhvillon mësimin të hënën, të mërkurën dhe të premten pasdite, por ka pasur shkolla që e zhvillonin mësimin në fundjavë: të premte, të shtunë, të diel. Për shkak të numrit të madh të nxënësve që frekuentojnë, GjKP-të “M. Domi” Elbasan dhe “K. Idromeno” Shkodër zhvillojnë mësim gjatë 5 ditëve të javës, sipas një orari ku çdo klasë paraqitet për mësim në tri ditë të ndryshme. Po kështu, GjKP-ja “K. Kristoforidhi” Tiranë zhvillon mësim me turne, paradite dhe pasdite.

5.5 Grupet e synuara (përfaqësimi gjinor, vendndodhja)

Sipas të dhënave të fundit të vjetarit statistikor për arsimin dhe sportin nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në vitin shkollor 2021-2022, 4915 nxënës kanë ndjekur GjKP-të në Shqipëri, nga të cilët 42% (2087) janë vajza/gra përkundrejt 58% (2828) djem/burra. Në raport me 10 vite më përpara, vihet re një ulje e numrit të nxënësve në GjKP me 67% (4610 nxënës kanë qenë të regjistruar në vitin shkollor 2011-2012, nga të cilët 37% vajza/ gra dhe 63% djem/burra). In relation to 10 years ago, there is a decrease in the number of pupils in the GJP by 67% (4610 students were enrolled in the 2011-2012 school year, of which 37% girls/ women and 63% boys/men).



Grafik 6: Të dhënat krahasuese për nxënësit e GJKP-ve në nivel kombëtar në 10 vitet e fundit




Grafik 7: Të dhënat gjinore të nxënësve në GJKP-të në nivel kombëtar në 10 vitet e fundit

Sipas akteve ligjore e nënligjore, gjimnazi me kohë të pjeshme ofrohet për të rriturit mbi 18 vjeç, të cilët nuk kanë mundësi të ndjekin gjimnazin me kohë të plotë, për

shkak të moshës¹⁰.

Në grafikun e mëposhtëm ilustrohet moshë që kanë nxënësit që ndjekin GjKP-në. Nga të dhënat e fundit zyrtare të aksesueshme¹¹, nxënësit e regjistruar në GjKP janë të grup-moshës 18-56 vjeç.



Grafik 8: Grup-mosha e nxënësve të regjistruar në GjKP-të në nivel kombëtar

5.6 Praktika e zbatimit të GJKP

Observatori gjatë muajit Maj 2024, realizoi disa takime vlerësuese në Bashkinë e Elbasanit, Dibrës dhe Durrësit. Shkollat që realizojnë GjKP në këto bashki janë:

- Gjimnazi "Said Najdeni", Dibër
- Gjimnazi "Olsi Lasko", Durrës
- Gjimnazi "Mahir Dom", Elbasan

¹⁰ Në klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë me kohë të plotë pranoen nxënës të moshës jo më të madhe se tetëmbëdhjetë vjeç." (neni 23 i ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar).

¹¹ Për vitin shkollor 2019-2020

Tabela 3: # i nxënësve të ndarë në grupmosha që tyre që ndjekin këtë arsim gjatë këtyre dy viteve të fundit

VITI AKADEMIK	GRUP MOSHA 16-29			GRUP MOSHA 30-40			GRUP MOSHA 16-29			TOTALI I PERSONAVE		
	F	M	T	F	M	T	F	M	T	F	M	T
2022-2023	30	90	120	47	43	90	12	05	17	89	138	227
2023-2024	40	80	120	50	40	90	12	05	17	102	125	227
GJKP "SAID NAJDENI" DIBER												
2022-2023	49	69	118	122	78	200	311	187	498	482	334	816
2023-2024	40	47	87	112	85	197	323	235	558	475	367	842
GJKP "MAHIR DOMI" ELBASAN												
2022-2023	26	37	66	56	96	152	49	51	100	131	184	315
2023-2024	52	44	98	44	86	130	60	54	114	156	184	340
GJKP "OLSI LASKO" DURRES												

Vëmë re që persona NEET që ndjekin GJKP është 1 në 5 persona (referuar totalit); Pjesmarrja e kësaj grupmoshe 16-29 ka qenë 304 gjatë vitit akademik 2022 – 2023 dhe 303 persona gjatë vitit 2023 – 2024, në këto 3 GJKP; Ky konsiderohet një numër i lartë NEET të cilët mund të orientohen më pas drejt kualifikim trajnimit ose punësimit.

Vihet re se **Elbasani ka nivelin më të lartë të personave që ndjekin GJKP, dhe krahasimisht me Durrësin e gati 3 herë më të lartë dhe krahasuar me Dibrën e ka gati 4 herë më të lartë.** Ky numër kaq i lartë i individëve që ndjekin GJKP në Elbasan, vjen dhe si rrjedhojë e politikave financiare që ndjek kjo bashki; Bashkia Elbasan është vetmja nga Bashkitë (krahasimit me Durrësin dhe Dibrën) që ofron burrsa financiare në ndihmë të personave me AK që ndjekin këtë nivel arsimor.

Tabela 4: # total i personave në GJKP

		TOTALI I PERSONAVE NË GJKP		
VITI AKADEMIK		FEMRA	MESHKUJ	TOTALI
GJKP "SAID NAJDENI" DIBER	2022-2023	89	138	227
	2023-2024	102	125	227
GJKP "MAHIR DOMI" ELBASAN	2022-2023	482	334	816
	2023-2024	475	367	842
GJKP "OLSI LASKO" DURRES	2022-2023	131	184	315
	2023-2024	156	184	340

Elbasani vihet re të ketë numrin më të lartë të vajzave dhe grave që ndjekin GJKP, krahasimit me djemtë dhe burrat; Ndërsa Durrësi dhe Dibra kanë numrin e djemve dhe burrave më të lartë. *Kjo tregon që GJKP vlerësohet si nevojë dhe interes për të dy gjinitë, - ndaj nxiten strukturat vendore që të jenë më afër komunitetit me fushata komunikimi dhe informimi në momentin që hapen klasat për ndjekjen e GJKP në periudhën Gusht – Tetor.*

Tabela 5: Vendbanimi dhe profesionet e personave në GJKP

TOTAL NUMBER OF PERSONS IN THE GJKP						
VITI AKADEMIK	QENDËR QYTETI	RRETHINA	PUNËTOR KRAHU	ZANATÇI	PA PUNË	TJETËR
2022 2023	+	+		+	+	
2023 2024	+	+		+	+	
GJKP "SAID NAJDENI" DIBER						
2022 2023	593	233	79	60	569	116
2023 2024	520	322	35	40	597	170
GJKP "MAHIR DOMI" ELBASAN						
2022 2023	126	189	63	112	22	118
2023 2024	119	221	59	136	27	118
GJKP "OLSI LASKO" DURRES						

- ■ *Bashkia Elbasan shpërndan (ofron) fond financiar plotësues/ nxitës për arsimim e personave me aftësi të kufizuar të vërtetuar nga KMCAP. Fondi shtesë që u jepet këtyre personave me AK nga Bashkia që ndjein GjKM është 10.000 all/ muaj. Aktualisht në Gjimnazi “Mahir Domi” kemi 972 persona që ndjekin GjKM të organizuar në paralele, duke qenë dhe shkolla me numrin më të lartë të të regjistruarve në GjKM në nivel kombëtar; nga këto persona, 375 janë persona AK me vërtetim nga KMCAP dhe që trajtohen me fondin shtesë nga Bashkia prej 10.000 all/ muaj. ■ ■*

(Gjimnazi “Mahir Domi” Elbasan)

- ■ *Në GJKP zhvillohet vetëm kurrikula bërthamë. Meqënëse maturantët e GJKP kanë të drejtë të konkurojnë njëloj si maturantët e gjimnazit të ditës, pse mos të kenë kurrikul me zgjedhje në maturë? Të zhvillojnë në maturë një këshillim karriere për punësim (modul). ■ ■*

(Afërdita Monçi, Gjimnazi “Mahir Domi” Elbasan)

Referuar faktit **që 1 në 3 persona që ndjekin GJKP banon larg qendrës së banimit** të bashkisë përkatëse, vlerësohet me shumë interes dhe dobi mundësia e rimbursimit të shpenzimeve të transportit për persona që udhëtojmë më shumë se 2 km për të ardhur në GJKP (referuar këtu ose qendrës së punës ose vendbanimit të tyre).

Vihet re se **gati 90% e personave që ndjekin GJKP janë ose të pa punë ose pa zanat** dhe si e tillë nevojitet të ngrihet një komunikim dhe bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Agjencise Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (DRAKPA) dhe Qendrën e Formimit Profesional (AFP), për të orientuar këto persona drejt aftësimin për punësim dhe punësimin.

Përveç mbarëvajtjes së kurrikulës dhe formës së organizimit të orës mësimore në klasat e arsimit me kohë të pjesshëm realizuar nga MAS, Bashkia është përgjegjëse dhe ka rol në organizimin dhe mbikëqyrjen e shkollave të mesme që realizojnë GJKP.

Nga komunikimi i realizuar me shkollat që realizon GJKP në Dibër, Durrës dhe Elbasan, vlerësohet që:

1. Bashkia Elbasan shpërndan (ofron) fond financiar plotësues/ nxitës për arsimim e personave me aftësi të kufizuar të vërtetuar nga KMCAP.
2. **Personat e regjistruar në GJKP tashmë funksionojnë të hedhur dhe në sistemin SMIP** (Gjimnazi “Mahir Domi” Elbasan dhe “Olsi Lako” Durrës).
3. Regjistrimet për GJKP hapen në periudhën 1 Korrik – 1 Shtator;
4. Informimi për hapjen e regjistrimeve për klasat e GJKP bëhet nëpërmjet rrjeteve sociale të shkollës ose (Durrësi) me anë të fletëpalosjeve që shpërndahen në komunitet.
5. **Regjistrimi tashmë realizohet Online, nëpërmjet e-albania.**
6. Dokumentet e nevojshme për regjistrim GJKP janë: (i) kartë identite, (ii) diploma e notave e 8-vjecares ose 9-vjecares;
7. Ditët dhe oraret që zhvillohen orët mësimore në ABKP janë 3 ditë në javë, përgjatë 34 ose 36 javëve të një viti akademik, me orar 16.00-20.00.
8. **Arsyet që ndjekin arsimimin me kohë të pjesshme tashmë, është pasi e kanë lënë shkollën në fëmijërinë e tyre për shkak të paragjykit apo martesës së hershme apo emigrimi në moshë fëminore; Tani i kthehen shkollës për arsye punësimi, pajisja me një diplomë të shkollës së mesme për të kryer punë të ndryshme në shtet dhe privat.**
9. Në shkollën “Olsi Lako” Durrës janë aktualisht 15 mësues (nga këto 7 të jashtëm) që zhvillojnë mësim në GJKP.

10. Në lidhje me profili i individëve që ndjekin GJKP, janë kryesisht persona të divorcuar, me status të trafikuar dhe urdhër mbrojtjeje, nxënës Rom dhe Egjyptian si dhe persona me aftësi të kufizuar.

■ ■ Praktika pozitive të GJKP

Në dy vitet e fundit, vemë re një rritje të numrit të personave që ndjekin Gjmnazin me kohë të pjesshme. Ndër praktikat pozitive që ne si shkollë kemi ndjekur janë: (1) fleksibiliteti i orareve sipas grupeve përkatëse për të ndjekur shkollën mbas orarit të punës, (2) rritja e aktivitete në bazë shkolle si dhe (3) ndjekja e praktikave të arsimit gjithëpërfshirës në shkollë. Po ashtu në shkollën tonë kemi shtuar orët konsultative online nëpërmjet Google Classroom. ■ ■

(Gjimnazi “Olsi Lako” Durrës)

■ ■ *Në shkollën tonë janë 180 fëmijë në arsimin bazë me kohë të plotë dhe 62 persona që ndjekin arsimin bazë me kohë të pjesshme (ABKP). Personat që ndjekin ABKP nuk marrin asnjë mbështetje financiare, ku me vlerë do të ishte të mund të rimbursohet udhëtimi dhe librat (ku librat mund të hynin në qarkullim duke përdorur ato të viteve të mëparshme që depozitohen në shkollë) ■ ■*

(Ilda Nako, shkolla “Ptoleme Xhuvani”, Elbasan)

Rekomandime për GJKP:

- 1.** GJKP të jenë më fleksibël në përcaktimin e orarit mësimor, ku të jetë pas orës 16.00, nisur kjo dhe nga fakti që shumë persona mbarojnë ditën e punës në orën 16.00.
- 2.** Bashkia të mund të ofrojë rimbursim transporti për personat që ndjekin GJKP dhe që qendra e banimit/ punës së tyre është mbi 2km larg nga vendndodhja e shkollës.
- 3.** M3.MAS të mund të sigurojë mundësinë rimbursimit ose teskteve falas të shkollës;

4. F4.Për të gjithë personat me aftësi të kufizuar mbi 16 vjeç dhe që ndjekin GJKP të mund t'u ofrohet një bonus financiar shtesë nga Bashkia.
5. T5.Bashkia të ketë një rol më aktiv në organizimin e fushatave informuese gjatë periudhës 1 Korrik – 1 Shtator, drejtuar komuniteteve e grupe të ndryshme të interesit për mundësinë e realizimit të GJKP pa shpërblyerje nga puna, dhe lehtësirat që ofrohen për ndjekjen e këtij arsimi. Ky informacion mund të jetë dhe pjesë e komunikimit dhe vlerësimit që realizojnë administratorët social në nivel vendor për personat që aplikojnë për asistencë financiare (NE).
6. E6.Të ngrihet një komunikim dhe bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Agjencise Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (DRAKPA) dhe Qendrën e Formimit Profesional (AFP), për të orientuar këto persona drejt aftësimin për punësim dhe punësimin.
7. A7.Adresimi i politikave nxitëse dhe lehtësuese nga Bashkia për të nxitur arsimimin në ABKP, kjo referuar ose lehtësirave për shkak të gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar, vendbanimit, numrit të fëmijëve në kujdestari, si dhe kushteve të tjera social ekonomike të familjes.
8. **ANdihmesë mund të jetë dhe hapja e klasave/ kabinetit AKELIUS në këtë shkollë, me qëllim lehtësimin e gjuhës angleze apo gjuhëve të huaja nga këto persona.**

VI. Përfundime

Ndër vite evidentohen trende rënëse të nxënësve që regjistrohen si në ABKP ashtu dhe në GJKP.

Mësuesit që ofrojnë mësim në ABKP dhe GJKP duhet të trajnohen dhe aftësohen në kapacitete në mënyrë të vazhdueshme.

Sipas akteve ligjore e nënligjore, arsimit bazë me kohë të pjesshme ofrohet për të rriturit mbi 16 vjeç, të cilët nuk kanë arritur ta mbarojnë arsimin bazë brenda moshës së detyrimit shkollor. Moshë më e vogël e nxënësve të regjistruar në arsimin bazë me kohë të pjesshme është 16 vjeç, ndërsa moshë më e madhe e nxënësve të regjistruar është mbi 50 vjeç. Pranimi dhe ndjekja e arsimit parauniversitar me kohë të pjesshme nuk ka moshë tavan, sikurse nuk ka kufizim moshë marrja e provimeve kombëtare të arsimit bazë, pas mbarimit të klasës së 9-të, apo e provimeve të Maturës Shtetërore, pas mbarimit të klasës më të lartë të arsimit të mesëm të lartë.

Nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të pjesshme, u nënshtrohen provimeve kombëtare si të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar me kohë të plotë. Kështu, në përfundim të klasës së 9-të, nxënësit e ABKP-së japin tri provimet kombëtare të arsimit bazë (gjuhë shqipe, gjuhë e huaj dhe matematikë), ndërsa nxënësit e GJKP-së japin katër provimet e Maturës Shtetërore (gjuhë shqipe dhe letërsi, gjuhë e huaj, matematikë dhe lëndë me zgjedhje).


Nxënësit që ndjekin arsimin bazë me kohë të pjesshme gëzojnë të drejtën, pasi pajisen me dëftesën e arsimit bazë, të vijojnë shkollimin në arsimin e mesëm të lartë me kohë të pjesshme. Nxënësit që mbarojnë gjimnazin me kohë të pjesshme, pasi pajisen me diplomën e Maturës Shtetërore, gëzojnë të drejtën të ndjekin institucionet e arsimit të lartë (IAL), duke aplikuar si të barabartë me të gjithë maturantët/kandidatët që plotësojnë kriteret e pranimit në IAL, sipas parimit meritë-preferencë.

VII. Rekomandime


Institucioni/et përgjegjëse

- 1.** Kryerja e një studimi kombëtar mbi situatën e arsimit me kohë të pjesshme në Shqipëri.
 - Studimi nga Organizatat e shoqërisë civile dhe donatorët.
 - Mbështetja me të dhena dhe bashkëpunim nga MAS dhe institucionet e tjera të arsimit parauniversitar.
- 2.** Rishikimi i kuadrit ligjor për të mundësuar dhënien e provimeve për individët që janë autodidakt në shtëpi.
 - Hartimi nga institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.
 - Miratimi nga MAS
- 3.** Rishikimi dhe pasurimi i programeve që mund të ofrohen në ABKP dhe GJKP (si kurse të përshpejtuara për aftësitë e buta, komunikimi etj.) për të lehtësuar hapat e edukimit për të rinjtë që kanë braktisur arsimin e detyruar (tetë- ose nëntëvjeçar) dhe tani janë mjaft të rritur për ta ndjekur rregullisht.
 - Hartimi nga institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.
 - Miratimi nga MAS.
- 4.** Vlerësim i nevojave që identifikohen nga mësuesit dhe nga vetë nxënësit për arsimimin me kohë të pjesshme në institucionet publike të arsimit parauniversitar.
 - Institucionet publike të arsimit parauniversitar (MAS, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar- AKAP, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar - DRAP, ZVA, Shkolla).
- 5.** Hartimi i udhëzuesve specifikë për të orientuar shkollat që ofrojnë ABKP dhe GJKP se cilat programe mësimore do të zbatohen dhe si të shfrytëzojnë tekstet shkollore që përdorin.
 - Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.

6. Përdorimi i teknologjive të edukimit digjital që ato të kenë mundësi ta ndjekin online, dhe në përfundim të studimeve ato marrin certifikatat përkatëse të akredituara, duke i lejuar studentët të studiojnë me ritmin e tyre dhe sipas orarit të tyre. Kjo mund të arrihet duke zhvilluar platforma dhe burime online që ofrojnë materiale të plota mësimi, tutoriale dhe module ndëraktive.

7. Hartimi i politikave planifikuese në projektion me ndryshimet dhe nevojat e grupit të synuar përfitues të arsimit me kohë të pjeshme. 


• MAS

8. Trajnime për forcimin e kapaciteteve të stafit mësimdhënës për ABKP-në dhe GJKP-në. 

• Institucionet publike të arsimit parauniversitar (MAS, AKAP, DRAP, ZVA, Shkolla).publike të arsimit parauniversitar (MAS, AKAP, DRAP, ZVA, Shkolla).

• Donatorë


• Organizata të shoqërisë civile.

9. Komunikim i drejtpërdrejtë me grupin e synuar përfitues për të rritur ndërgjegjësimin mbi mundësitë për arsimimin me kohë të pjeshme, si dhe përthithjen në këtë formë arsimimi. Kjo mund të arrihet nëpërmjet fushatave informative dhe promovimeve në platformat sociale dhe tradicionale të medias 

• Shkollat

• Organizata të shoqërisë civile

• Grupe interesi

10. Shndërrimi i shkollave që nuk janë në përdorim, duke ndarë të paktën një për qark, në institucione të dedikuara për arsimin me kohë të pjeshme 

• MAS

• Bashkia

11.

Rrjetëzime dhe takime periodike ndërmjet stafeve mësimore të shkollave që ofrojnë arsimim me kohë të pjeshme në arsimim parauniversitar, për ndarjen dhe shkëmbimin e përvojave dhe të praktikave më të mira.

- Shkollat
- ZVA
- Organizata të shoqërisë civile.
- Grupe interesi

12.

Hartimi i politikave planifikuese në projektion me ndryshimet dhe nevojat e grupit të synuar përfitues të arsimimit me kohë të pjeshme.

- Shkollat
- AKPA
- Qendrat e Formimit Profesionalcivile
- Organizata të shoqërisë civile
- Grupe interesi

13.

Monitorime periodike dhe të herëpashershme të të gjitha shkollave të ABKP-së dhe GJKP-të, për të siguruar ecurinë dhe përparim të programeve të arsimit me kohë të pjeshme për të siguruar efektivitetin dhe përgjegjshmërinë e tyre; Instrument lehtësues këtu mund të jetë përdorimi i sistemit SMIP.

- Hartimi i raporteve përmbledhëse të monitorimeve periodike nga AKAP dhe DRAP.
- Raportet i paraqiten MAS

14.

Ofrimin e bursave dhe ndihmës financiare për studentët që mund të përballen me pengesa ekonomike për të vazhduar arsimin e tyre me kohë të pjeshme.

- MAS
- Bashkia
- Shkolla
- Njësia Administrative
- OJF

15.

Bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Arsimit Profesional, Trajnimit dhe Kualifikimeve për të nxitur njohjen e përvojave të punës dhe të nxënësve praktik si arsim joformal dhe informal

- MAS
- Ministrise se Ekonomise, Kulture dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Af-tësive (AKPA)